



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 81 datë 23.09 2025

**PËR “MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
BASHKISË PËRMET DHE SHOQATËS KOMBËTARE TË BASHKIVË TË
SHQIPËRISË PËR PAGESËN E KUOTËS SË ANËTARËSISË ,SI DHE DHËNIEN E
AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr. 44 datë 30.04.2015 të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr. 8750, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, VKB Nr. 107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2025" i ndryshuar, si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë me objekt pagesën e kuotës së antarësisë nga Bashkia Përmet për Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë.
2. Fondi i parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë është 200.000 (dyqind mijë) lekë.
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës,Planifikimit të Territorit, Sektorit Juridik e Prokurimeve, Drejtoria e Financë-Buxhet, Sektori i Burimeve Njerëzore.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA PËRMET



SHOQATA
KOMBËTARE
E BASHKIVË
TË SHQIPËRISË

SHOQATA E BASHKIVË TË SHQIPËRISË

Nr. _____ Prot. datë . .2025

Nr. _____ Prot. datë . .2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, me datë . .2025, ndërmjet palëve si më poshtë:

BASHKIA PËRMET, person juridik me NIPT K49719214P me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri” përfaqësuar nga Kryetare e Bashkisë Zj. **Alma HOXHA** në vijim referuar si “Bashkia”.

dhe

SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVË TË SHQIPËRISË me NIPT L01327453K, e përfaqësuar nga Adelina Farrici, mbajtëse e kartës identitetit nr.G85408092R, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv, adresa Rruga Ibrahim Rugova, kompleksi Green Park, kulla 1, kati 6, Tiranë.

Baza ligjore:

- Ligji nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “Për buxhetin e Bashkisë viti 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve dhe Njësive Administrative në varësi të saj, i ndryshuar.
- Kërkesë për pagesë kuotë anëtaresie Nr.451 Prot., datë 03 Mars 2025.

Neni 1

Objekti



Objekti i kësaj marrëveshje është pagesa e kuotës së Antarësisë nga Bashkia PËRMET për Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, të përcaktuara sipas VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2025”i ndryshuar anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë”.

Fondi i parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, është 200.000 (dyqind mijë) lekë.

Neni 2

Afati i marrëveshjes së bashkëpunimit

Efektet financiare të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të jenë nga momenti i nënshkrimit deri në kalimin e fondit të anëtarësisë.

Neni 3

Rolet dhe përgjegjësitë

Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë për lëvrimin e fondit të vënë në dispozicion në buxhetin e Bashkisë Përmet duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë për transferim fondi të detajuar;
- Certifikatë Regjistrimi NIPT
- Vërtetim llogarie bankare
- Vendimin e gjykatës për ndryshimin e emrit

Neni 4

Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Përmet

Bashkia PËRMET, ka miratuar fondin me VKB Nr. 107 datë 18.12.2024 “Për buxhetin e Bashkisë viti 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve dhe Njësive Administrative në varësi të saj,i ndryshuar.

Drejtoria burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse pranë Bashkisë Përmet pas shqyrtimit të kërkesës dhe pas konfirmimit të saj, përgatit procedurën për transferimin e fondit, të cilën ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar në Bashkinë Përmet për transferimin/kalimin e fondit.

Bashkia Përmet,Drejtoria Financës do të realizojë procedurën e transferimit të fondit sipas dispozitave ligjore drejt Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, pas dorëzimit të kërkesës për kalimin e fondit, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës.



Neni 5
Mënyra e lëvrimit të fondit

Bashkia Përmet, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar do të bëjë transferimin e vlerës, të përcaktuar në kërkesë, nga fondi i miratuar, në llogari të Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt për zgjidhjen mosmarrëveshjeve, palët mund t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

Neni 7
Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër kopje) të barazvlefshme. Palët pasi lexuan marrëveshjen e bashkëpunimit, me vullnetin e tyre të lirë, e nënshkruan atë.

PËR
BASHKINË PËRMET

KRYETAR
Alma HOXHA

PËR
SHOQATËN KOMBËTARE TË BASHKIVE TË
SHQIPËRISË

Drejtori ekzekutiv
Adelina FARRICI